



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

### NJOFTIM PËR VEND PUNE SI “INSPEKTOR I STRUKTURËS MBËSHTETËSE TË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE”

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i krijuar në kuadër të Ligjit nr. 100/91 datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, me seli në rrugën Rr.” Ismail Qemali”, Pallati 5, Kati i II-të, Ap. 8, Tiranë kërkon të punësojë një “Inspektor të Strukturës Mbështetëse”.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- Të ketë zotësi për të vepruar;
- Të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet auditim, kontabilitet ose financë, si dhe të ketë jo më pak se 10 vite përvojë pune të përgjithshme në fushën e auditimit ligjor dhe të raportimit financiar, kombinuar me trajnime specifike për dhënie të sigurisë së cilësisë. Nëse trajnimet konsiderohen të pamjaftueshme ato duhet të kryhen brenda dy viteve nga momenti i lidhjes së kontratës së punës;
- Të mos ushtrojë profesionin e audituesit ligjor dhe të mos jetë i punësuar apo i angazhuar me një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;
- Të mos jenë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore të largimit nga puna për shkak të një shkelje të rëndë disiplinore;
- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë;
- Të zotërojë gjuhën Angleze në nivel të pranueshëm dhe të përshtatshëm për punën.

Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë kandidati:

- Letër motivimi;
- Dokument Identifikimi;
- CV;
- Fotokopje e diplomës dhe lista e notave;
- Reference pune nga punëdhënësi i mëparshëm.

Personat e interesuar duhet të paraqesin këto dokumenta në adresën [info@bmp.al](mailto:info@bmp.al) deri në datën 20.02.2019.